

VENDIM
Nr. 12, datë 18.5.2026

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR
RREGULLATOR NR. 7, DATË 22.2.2023, “PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME GJIROKASTËR SHA”**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102); të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM-ja nr. 958), si dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (Rregullore e licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 18.5.2026, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e vendimit ‘Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 7, datë 22.2.2023, ‘Për licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Gjirokastër sh.a.’””.

KONSTATOI SE:

1. Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Gjirokastër sh.a., me shkresën nr. 679 prot., datë 31.3.2026 dhe plotësimet me shkresën nr. 859/1 prot., datë 22.4.2026, me lëndë “Dërgim dokumentacioni për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik”, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik të shoqërisë, të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit, të ndryshuar.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Gjirokastër sh.a., për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe Rregulloren e Licencimit, të ndryshuar.

3. KKRR-ja ka licencuar Shoqërinë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Gjirokastër me vendimin nr. 7, datë 22.2.2023, “Për licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Gjirokastër”, me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik dhe largimit të ujërave të ndotura.

4. Drejtuesi teknik i shoqërisë në vendimin nr. 7, datë 22.2.2023, “Për licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Gjirokastër sh.a.”, ishte z. Bashkim Tola, i diplomuar në Universitetin Politeknik, në profilin Inxhinieri e Shpimit të Puseve, viti 1997, i cili në këtë aplikim është zëvendësuar nga znj. Çelestina Dajlani, Inxhinieri Hidroteknike e diplomuar në Universiteti Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, viti 2013. Znj. Dajlani ka një eksperiencë mbi 10-vjeçare në sektorin UK, prej vitit 2015 ka qenë Inxhinieri në Drejtorinë Teknike të ish-shoqërisë UK Gjirokastër sh.a., më pas Përgjegjëse e Kontrollit të Humbjeve dhe Menaxhimit të Projekteve, pranë SHRUK-së Gjirokastër sh.a. dhe së fundmi mban pozicionin e drejtorit teknik pranë kësaj shoqërie. Znj. Dajlani plotëson kërkesat e VKM-së nr. 958, mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion.

5. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-

Kanalizime Gjirokastër sh.a. të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958, dhe Rregullores së Licencimit, të ndryshuar, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve, në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e SHRUK-së Gjirokastër sh.a. është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Germa “b”, e pikës 2, të vendimit të KKRR-së nr. 7, datë 22.2.2023, “Për licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Gjirokastër sh.a.”, bëhet si më poshtë:

“b) Drejtues Teknik – znj. Çelestina Dajlani.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gerta Lubonja